



## SYLLABUS I LËNDËS “EERGONOMIA E PYJEVE”

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Shkencave të Pyjeve dhe Mjedisit</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Ergonomia e Pyjeve</b>
<b>Programi:</b>	<b>Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative (O)</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>2022/2023</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3 + 2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Do shpallet</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof.Asoc.Dr. Ylli Kortoci</b>
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	<b>E- mail:<a href="mailto:ylli.kortoci@uni.prizren.com">ylli.kortoci@uni.prizren.com</a>;Mob.+38345846817</b>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p>Në modulën e Ergonomisë pyjore trajtohen tema të cilat i vijnë në ndihmë përgatitjes së studentëve si teknikien të ardhshëm të mbarestrimit të qendrueshëm të pyjeve dhe mjedisit në teresi. Nga temat më të rëndësishme mund të përmendim: Qellimi dhe hyrje në ergonominë pyjore, e cila trajton subjektin e studimit të modulit dhe argumentimin e ndarjes së ergonomisë si lëndë më vete në shkencat pyjore në Europë dhe Kosovë. Në këto tema jepet përkufizimet e termave më të përdorshëm të lëndës. Gjithashtu në këtë modul krijohet mundësia që studentët marrin njohuri të nevojshme për fiziologjinë e punës së njeriut, për kontraktimin e muskujve dhe qarkullimin e gjakut. Po në nivelin e duhur ata marrin njohuri për performancën fizike dhe mendore të njeriut në punë, për kërkesat, aftësitë dhe mundësitë për ekzekutimin e punës.</p> <p>Më tej studentët marrin njohuri teorike të plota për të ushqyerit e punetoreve, për prodhimin dhe konsumin e energjisë në organizmin e njeriut, si nocione të domosdoshme për të kuptuar rendimentin dhe prodhimtarinë ditore të punëtorit. Po ashtu një rëndësi e veçantë i kushtohet studimit të faktorëve ndikues në kryerjen e punës në fushën e pyjeve ku përparësinë e marrin faktorët fizikë dhe teknologjikë.</p> <p>Siguria dhe shëndeti në punë në punimet pyjore është objekti më i rëndësishëm i studimit të modulit të ergonomisë. Përdorimi i sigurt mjeteve dhe makinerive pyjore në përputhje me rregullat në fuqi jo vetëm që shton të ardhurat për punëtorët por mbron ata nga aksidentet e mundshme që në shumicën e rasteve janë fatale si dhe mjedisin pyjor nga dëmtimet. Studentët përgatiten për të qenë të aftë pas mbarimit të shkollës të trajtojnë punëtorët për</p>

	<p>kryerjen e punes dhe perdorimin e mjeteve dhe makinave pyjore ne menyre te sigurt.</p> <p>Po ashtu nje rendesi te veçante i kushtohet sigurise ne pune ne operacionet e prerjes se drurit dhe perdorimit praktike te mjeteve prerese si motosharra profesionale dhe jo profesionale. Operacionet e heqjes se degeve, heqjes se levores dhe coptimit te lendes drusore trajtohen ne kompleks jo vetem nga ana sigurise ne pune por edhe nga ana tekniko-ekonomike duke zbatuar teknika te reja pune per kryerjen e tyre.</p> <p>Gjithashtu aksidentet ne pune dhe kontrolli ergonomik i kryerjes se punes studjohen dhe raportohen ne perputhje me treguesit perkates. Ne perfundim te modulit trajtohen detyrat dhe pergjegjesite e inspektoratit te punes, punedhenesve, punemarresve, kontraktoreve dhe prodhuesve.</p>		
<b>Qëllimi i lëndës:</b>	<p>Through the "Forest cutting" subject program students will receive the necessary information in:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Means of intervention through cuttings in forest;</li> <li>✓ Designing the parcel where it will be intervened by cuttings;</li> <li>✓ Using the technologies adapted to Kosovo, and the advanced technologies used today in the world; Equipment and cutting technologies.</li> <li>✓ Timber extraction roads and the ways they are used. Productive and unproductive times, avoiding lost time. Organization of the site etc.</li> </ul>		
<b>Rezultatet e të nxënit:</b>	<p>Pas perfundimit te ketij kursi studenti duhet te jene ne gjendje te:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Pershkruajn fiziologjine e punes se njeriut ( muskujt, frymemarrjen dhe qarkullimin e gjakut);</li> <li>✓ Shpjegojone performancen fizike dhe lodhjen e punetorit;</li> <li>✓ Llogarisin bilancin energjistik ( energjine metabolike dhe energjine per pune);</li> <li>✓ Zgjedhin ushqimin dhe te ushqyerit e punetorit;</li> <li>✓ Klasifikojne semundjet dhe rrezikun e tyre</li> <li>✓ Propozojnë rregullat kryesore te sigurise dhe shendetit ne pune.</li> </ul>		
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	3	15	45



Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në terren	1	15	15
Kollokfiume, seminare	2	-	2
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	2	5	10
Projektet, prezantimet ,etj	3	-	3
<b>Totali</b>			<b>150 orë (6 ECTS)</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, diskutime, ushtrime laboratorike, ekspedita, konsultime, seminare, projekte të pavarura, kolokviume, detyre kursi, provime.		
<b>Metodologjia e vlerësimit:</b>	Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 5%, Provimi final: 70%, Total: 100%.		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura primare:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. MineV. Leksionet e ergonomise 2014 ( detyruar)</li> <li>2. Mine V. “Siguria dhe Shendeti ne Punimet Pyjore” 2002 (ILO Kod Praktik) ( detyruar)</li> <li>3. S. Baldini, A. Cioe, R. Picchio. “Sicurezza ed Antinfortunistica nei Cantieri Forestali e di Manutenzione del Verde Urbano. Valutazione dei Rischi”. Roma 2002</li> <li>4. KORTOÇI, Y., KELLEZI, M. (2012): Shfrytezimi i pyjeve te ahut te Shqiperise me nje silvikulture te qendrushme.</li> </ol>		
<b>Literatura shitesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>5. Mine V. ‘Ergonomia &amp; siguria ne pune (2012) ( detyruar)</li> <li>6. Baldini, A. Cioe, R. Picchio. “Sicurezza ed Antinfortunistica nei Cantieri Forestali e di Manutenzione del Verde Urbano. Valutazione dei Rischi”. Roma 2002</li> <li>7. Luciano Martarello, Arturo Millesi, Renzo Rey, Nevio Yeullaz, Giancarlo Zorzetto -</li> <li>8. Struttura forestazione e sentieristica - Regione Autonoma Valle d’Aosta (Quart).</li> <li>9. Ruggero Marazzato, Tiziano Martin - Settore Gestione Proprietà Forestali Regionali e</li> </ol>		

	<p>10. Vivaistiche - Regione Piemonte (Vercelli).</p> <p>11. Giuseppe Salvo - Dipartimento Agricoltura, Turismo e Cultura - Servizio Politiche della</p> <p>12. Montagna e della Fauna Selvatica - Regione Liguria (Genova).</p> <p>13. Serge Kieffer - Centre Forestier de la Région Provence-Alpes-Côte d'Azur (La Bastide des Jourdans).</p>
--	---

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>		
<b>Java</b>	<b>Ligjërata</b>	<b>Ushtrime</b>
<i>Java e parë:</i>	Ergonomia, qëllimi, zhvillimi dhe lidhja e saj me shkencat e tjera.	Ergonomia e zbatuar.
<i>Java e dytë:</i>	Qarkullimi i gjakut dhe frymemarrja.	Qarkullimi i gjakut .
<i>Java e tretë:</i>	Muskujt dhe kontraktimi i tyre. Lodhja e muskujve.	Qarkullimi i gjakut dhe rregullimi i tij gjatë ushtrimeve fizike.
<i>Java e katërt:</i>	Performanca fizike, ekzekutimi i punës.	Faktoret që ndikojne ne performancën e njeriut
<i>Java e pestë:</i>	Energjia e shpenzuar, klasifikimi i punës.	Klasifikimi i punës
<i>Java e gjashtë:</i>	Të ushqyerit e punëtorëve.	Kategorite e ushqimit. Metodrat e vlerësimit të marrjes së energjisë dhe ushqimit
<i>Java e shtatë:</i>	Faktorët fizik dhe teknologjik, që ndikojnë në studimin e punës.	Klima, zhurmat dhe vibracionet. Masat mbrojtëse nga zhurmat dhe vibracionet
<i>Java e tetë:</i>	Vlerësimi i parë intermedier.	Zhvillimi historik i rolit të personelit. Zgjedhja e personelit dhe intervistimi
<i>Java e nëntë:</i>	Zhvillimi i burimeve njerezore. Zgjedhja e personelit.	Perkufizimi i projektimit të punës. Konsiderata fizike dhe fiziologjike në projektimin e punës.



<i>Java e dhjetë:</i>	Projektimi dhe organizimi i punës.	Matja e punës dhe faktorët ndikues dhe studimi i performances së punës
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Studimi i faktorëve ndikues në studimin e punës në pyje	Metodat e studimit të punës dhe menyrat e matjes së koheve të punës
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Studimi i punës dhe llogaritja e madhësisë së sondazhit dhe vendosja e standardeve të reja të punës.	Shembuj nga semundjet profesionale
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Semundjet profesionale në punimet pyjore	Organizimi i punës. Shfrytëzimi i pyjeve. Nxjerrja/ Transporti i brendshëm Operacionet me rrezikshmeri të lartë. Studimi i aksidenteve dhe kontrolli ergonomik
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Studimet e punimeve në: ndërhyrjet silvikulturore, shfrytëzimi i pyjeve, nxjerrja/ transporti i brendshëm.	Pajisjet Mbrojtëse Personale të përshtatshme për operacionet pyjore dhe ndihma e parë
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Veshje e punës dhe pajisjet mbrojtëse personale	Shërbimet e shëndetit profesional. Ndihma e parë, emergjencës dhe shërbimet shëndetësore profesionale
<b>Politikat akademike dhe kodi i sjelljes</b>		
<p>Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive e studentëve në ligjërata, ushtrime (pjesën praktike) dhe në punë seminarike.</p> <p>Mbajtja e qetësisë në mësim, çkyçja e telefonave celular, hyrja me kohë në sallë të mësimi etj..</p>		